



Prania / Dorezuar Priljena / Prilato Received / Delivered	16.05.2022	2	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shënia Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMISHOL	2847/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.354/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.354/2022 të datës 08.04.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me Nr. Prot:2655 të datës 06.04.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.354/2022 e datës 08.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 08.04.2022 fizikisht ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 1988/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. Prot:2655 të datës 06.04.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me pretendimet për shkelje të dispozitave të procedurës administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:1988/2022 të datës 08.04.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Prot:2655 të datës 06.04.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Dëftesë për pranimin e dërgesës e datës 11.03.2022; Padi për Konfliktin Administrativ për Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e **pabazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosje e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.02.2022 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.37/2022 me të cilin ka refuzuar ankesën e datës 03.08.2020 të ankuesit duke e lënë në fuqi Vendimin me numër protokolli 5616 të datës 28.07.2020 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.

Në zbatim të Vendimit me numër A.nr.37/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 06.04.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. Port:3655 me të cilin ka obliguar Divizionin e Burimeve Njerëzore që të kryej procedimin dhe administrimin sipas procedurave të përcaktuara ligjore për zbatimin e Vendimit me numër protokolli 5616 të datës 28.07.2020 të Komisionit Disiplinor.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të nenit 21 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar që: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”,* si rrjedhojë meqenëse Vendimi me numër protokolli 5616 i datës 28.07.2020 i Komisionit Disiplinor nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është vërtetuar si vendim i drejtë dhe i ligjshëm, atëherë me qëllim të zbatimit të këtij vendimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka ndërmarr veprimet e nevojshme juridike.

Bazuar në këtë, si dhe duke i'u referuar provave të lëndës, ankuesi kundër Vendimit me numër A.nr.37/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes padisë së datës 11.03.2022 ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.



Andaj duke marr parasysh rrethanat e lartcekura, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duku u bazuar në shkresat e lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.354/2022, datë 16/05/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- ❖ Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

